



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 19 shtator 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Haki Demolli, Ardian Gjini, Halit Krasniqi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Amir Ahmeti, Mufera Şinik dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Shqipe Osmani – Bota Sot, Lumnije Murati – ZPRK, Natyra Kasumaj – NDI, Arbër Jashari – Klan Kosova, Merita Stublla Emini – USAID, Albert Avdiu – KGJK dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25. 07. 2011;
3. Diskutim rreth përbërjes së Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës nr. 04/L-70;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë me amendamentet e propozuara nga grupi punës;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-59 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës;
7. Shqyrtimi i shkresës së NTPB “Hibridi” nga Gjilani, lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore;
8. Të ndryshme.

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25. 07. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25. 07. 2011, pa vërejtje.

3. Diskutim rreth përbërjes së Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Komisioni debatoi rreth përbërjes së Këshillit Gjyqësor. U diskutua për çështjen e emërimit të anëtarëve, për konfliktin e interesit dhe për anëtarët që vijnë nga gjyqësori. Për këtë pikë diskutuan Arben Gashi, Arsim Bajrami, Albert Avdiu nga KGJK-ja, Armend Zemaj, Ardian Gjini dhe Halit Krasniqi.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të marrë vendim sa i përket çështjes së konfliktit të interesit, emërimit të tre anëtarëve të KGJK-së dhe çështja e anëtarëve të Këshilli që vijnë nga radhët e gjyqësorit.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës nr. 04/L-70

Komisioni vlerësoi se Projektligji për nismat legislative, i plotëson kushtet e përcaktuara që të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në parim.

Kryetari - Konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nr. 04/L-70

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë me amendamentet e propozuara nga grupi i punës

Albulena Haxhiu - Në cilësinë e kryesueses së grupit të punës e njoftoi Komisionin se grupi i punës e ka shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe nuk ka paraqitur ndonjë amendament, sepse është P/L për ndryshim dhe plotësim. Risi në të është përfshirja edhe e ish-kryetarit të Kuvendit, e ish-kryeministrit, e ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, e ish-kryeprokurorit të Shtetit dhe e ish-kryetarit të Gjykatës Supreme. Theksoi se ka marrë pjesë në këtë grup pune, duke menduar se ka të drejtë të bëjë ndërhyrje edhe në ligjin bazik dhe e kuptoi se nuk e kemi atë mundësi si grup i punës, prandaj nuk kemi paraqitur ndonjë amendament dhe nuk kemi vërejtje në këtë Projektligj.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

I. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitim të ish-zyrtarëve të lartë, pa ndryshime.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-59 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin 6. nr. 04/L-59 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës. Ishin të diskutueshme amendamentet 1, 2 dhe 5, për të cilat diskutuan: Arben Gashi, Ardian Gjini dhe Albulena Haxhiu.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-59 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
 2. Amendamentet 1, 2 dhe 5 nuk kanë bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 79) dhe në Rregulloren e Kuvendit (neni 55) dhe nuk mund të procedohen për shqyrtim të mëtutjeshëm.
 3. Komisioni për Legjislacion vendosi t'i kthehen për rishqyrtim amendamentet Komisionit Funkcional dhe pas rishqyrtimit t'i procedohen Komisionit për Legjislacion për vlerësimin e bazës juridike të amendamenteve të propozuara.
- ### **7. Shqyrtimi i shkresës së NTPB “Hibridi“ nga Gjilani, lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore**

Komisioni e shqyrtoi shkresën e NTPB “Hibridi“ nga Gjilani, lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe vlerësoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprim. Ai këtë kërkesë ia dërgoi Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komisioni funksional për procedim të mëtutjeshëm.

8. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi